



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Përmet, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “M.A.K STUDIO” shpk & “HMK – CONSULTING” shpk**

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim**

Numri i referencës së procedurës: **REF-91568-03-29-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Supervizion punimesh për objektin "Ndërtim i Ujësjiellit Pacomit, Bashkia Përmet"**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s'ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “FIRMITAS STUDIO” shpk** me NIPT L91708008J me vlerë të ofertës 1 204 823,37 (një milion e dyqind e katër mijë e tetëqind e njëzetë e tre presje tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1 445 788,04 (një milion e katërqind e dyzetë e pesë mijë e shatëqind e tetëdhjetë e tetë presje zero katër) me TVSH.
- 2- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “M.A.K STUDIO” shpk me NIPT L014220170 & “HMK – CONSULTING” shpk me NIPT L57129604Q** me vlerë të ofertës 1 120 108,34 (një milion njëqind e njëzet mijë e njëqind e tetë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe 1 344 130,01 (një milion e treqind e dyzet e katër mijë e njëqind e tridhjetë presje zero një) me TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

**Operatori Ekonomik “FIRMITAS STUDIO” shpk**

Nga shqyrtimi në sistem ky OE nuk ka dorëzuar në SPE:

- Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar ky operator nuk ka dorëzuar asnjë dokument në SPE.
- Në lidhje me pikën 3.1 a) kontrata e dorëzuar prej këtij OE si shërbim i ngjashëm është në një vlerë më të ulët se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit. Po kështu nuk ka

dorëzuar vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate si dhe Situacionin përfundimtar, Akt Kolaudimin, Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

- Në lidhje me pikë 3.2 në liçensën profesionale të shoqërisë për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi ky OE nuk ka kategoritë NP – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit; NS - 9 Punime strukturore speciale; NS - 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij; NS - 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.
- Në lidhje me pikë 3.3 nuk përmbush një numër mesatar jo më pak se 13 (trembëdhjetë) punonjës të siguruar për periudhën Shtator 2020- Shkurt 2021. Nuk ka dorëzuar asnjë dokument për pikën 3.3.b)
- Në lidhje me pikë 3.4 për drejtuesit teknik të shoqërisë OE nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë.
- Në lidhje me pikën 3.6 nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë.
- Nuk ka paraqitur asnjë dokument në SPE për përmbushjen e pikave 3.5; 3.7; 3.8, 3.9; 3.10; 3.11, 3.12.

Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

### **Oferta të kualifikuara:**

#### **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M.A.K STUDIO” shpk & “HMK – CONSULTING” shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “M.A.K STUDIO” shpk & “HMK – CONSULTING” shpk**, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DST të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “M.A.K STUDIO” shpk & “HMK – CONSULTING” shpk me adresë Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Irfan Tomini”, pallati i Shoqërisë Cani nr. 1, kati i parë Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1 120 108,34 (një milion njëqind e njëzet mijë e njëqind e tetë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 14.04.2021**

**Ankesa: NUK KA**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Alma HOXHA**